

KONTRATE SHITJE
KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 09/03/2022 (dymijë e njëzetë e dy), lidhet kjo Kontratë shitje kuote ndërmjet palëve të mëposhtme:


1. **Arian Kraja**, i datëlindjes 10.08.1965, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike dhe zotësi për të vepruar, me cilësinë e një prej ortakëve të Shoqërisë "ERGENT-CO" shpk, zotërues i 50% të kapitalit të kësaj Shoqërie, mbajtës i dokumentit të identifikimit me numër personal G50810164E, këtu e më poshtë referuar si **SHITËSI**.

Dhe

2. **Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k.**, me cilësinë e një prej ortakëve të Shoqërisë "ERGENT-CO" shpk, zotërues i 50% të kapitalit të kësaj Shoqërie, person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 14.06.2005, me Vendimin Nr. 33729, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me seli në adresën: rruga "Perlat Rexhepi" Nd.1. H. 14, Ap. 7, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri, me NIPT K81602049K, e përfaqësuar në këtë kontratë nga Administratori **Z. Adrian Dulaku**, i datëlindjes 05 Shkurt 1960, lindur në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me numër 035240347 dhe numër personal G00205223S, me datë lëshimi 04.12.2019, autoritet lëshues MB, këtu e më poshtë referuar si **BLERËSI**.

KUSHTE PARAPRAKE

- A. **Z. Arian Kraja** është një nga dy ortakët në Shoqërinë "ERGENT-CO" shpk, duke zotëruar 50% të kapitalit të kësaj Shoqërie, e themeluar në 18.10.2010, me NUIS L02220021F, me kapital 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe me adresë: Kompleks Vilash, Rruga e Çollakëve, Farkë e Vogël, Tiranë.
- B. **Z. Arian Kraja**, në pozitën e Shitësit dëshiron të shesë, me vlerën e saj nominale, 25% të kuotës së tij në Shoqërinë "ERGENT-CO" shpk te Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" shpk, në përputhje me vendimin e Asamblesë së Shoqërisë nr. 2 datë 09.03.2022.



- C. Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" shpk, e cila zotërohet nga ortakët Adrian Dulaku, Artan Dulaku dhe Genci Dulaku, dëshiron ta blejë 25% të kuotës së ortakut Arian Kraja, duke ndryshuar përqindjen e saj takuese në Shoqërinë "ERGENT-CO" shpk, nga 50% në 75% të kapitalit të saj.

Për sa më lart, Shitësi dhe Blerësi lidhin këtë Kontratë duke rënë dakord si vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është shitblerja e 25% të kuotës që zotëron Ortaku Arian Kraja në Shoqërisë "ERGENT-CO" shpk, te Blerësi, Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" shpk. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, ortakut Arian Kraja do zotërojë 25% të kapitalit të Shoqërisë, kurse ortakut tjetër, Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" shpk, do të zotërojë 75% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 2

Baza ligjore

Kalimi i kuotës në këtë Kontratë bazohet në ligjin nr. 9901, date 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Neni 3

Garancitë e ndërsjella

Shitësi garanton Blerësin se është pronar me të drejta të plota mbi objektin e Kontratës, dhe se kuota është e lirë dhe pa asnjë barrë rënduese. Të gjitha garancitë e dhëna nga Shitësi dhe të pranuar nga Blerësi, vazhdojnë të mbeten të vlefshme deri në ekzekutimin e plotë të kësaj kontrate si dhe në çdo moment pas përmbushjes së kontratës.


Neni 4

Çmimi

1. Çmimi për 25% të vlerës së kuotës, objekt i kësaj Kontrate, është 25'000 (njëzetë e pesë mijë) Lekë.
2. Palët pranojnë se shlyerja e kësaj vlere do të kryhet brenda 15 ditëve nga dita e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe mandati bankar do i bashkëlidhet Kontratës.

Neni 5

Transferimi i kuotave



1. Transferimi i përqindjes së kuotës objekt Kontrate bëhet efektiv, pa asnjë kufizim, në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.
2. Kjo Kontratë do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit nga Blerësi, me qëllim pasqyrimin, pa kufizim, të ndryshimit të përqindjes ndërmjet ortakërisë në Shoqërinë "ERGENT-CO" shpk, si rezultat i pasojës që vjen nga kjo Kontrate.
3. Palët konfirmojnë se me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi Arian Kraja do të zhvishet nga zotërimi i 25% të kuotës në Shoqërinë "ERGENT-CO" shpk dhe Blerësi, duke qëndruar ortak në Shoqëri me 25% të kapitalit të saj, kurse përqindja takuese e Shoqërisë "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. do rritet, nga 50% në 75%.
4. Palët përgjigjen personalisht për detyrimet fiskale që mund të aplikohen për shkak të kalimit të kuotave, siç parashikohet nga dispozitat ligjore.

Neni 6 Të fundit

Palët angazhohen që të zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që lindin gjatë përmbushjes së kësaj Kontrate. Në çdo rast, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo Kontrate nënshkruhet në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlefshmëri të njëjtë. Palët e kësaj kontrate mbajnë nga dy kopje origjinale të Kontratës, kurse kopja e pestë do depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit nga Blerësi.

BLERËSI

Shoqëria "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k.

Përfaqësuar nga

Administratori

Adrian Dulaku



SHITËSI

Arian Kraja

